


VITI MBARËKOMBËTAR / GJERGJ  
KASTROITI SKENDEBETEUT - 2018



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE

VENDIM

Nr. 417, datë 4.7.2018

PËR

MIRATIMIN, NË PARIM, TË MARRËVESHJES, NDËRMJET  
KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË  
DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS POPULLORE TË KINËS,  
PËR THEMELIMIN E QENDRËS KULTURORE TË KINËS  
NË SHQIPËRI

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 10, të ligjit nr.43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Kulturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin, në parim, të marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Popullore të Kinës, për themelimin e Qendrës Kulturore të Kinës në Shqipëri, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI

EDI RAMA

MINISTRI I KULTURËS  
MIRELA KUMBARO PURXHI

**MARRËVESHJE  
NDËRMJET  
QEVERISË SË REPUBLIKËS POPULLORE TË KINËS  
DHE  
KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË  
PËR THEMELIMIN E QENDRËS KULTURORE TË KINËS NË SHQIPËRI  
(Draft)**

Qeveria e Republikës Popullore të Kinës dhe Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë (referuar më poshtë përkatësisht si "Pala kineze" dhe "Pala shqiptare", së bashku si "Palët"), me qëllim nxitjen e marrëdhënieve miqësore, zgjerimin e miqësisë dhe bashkëpunimin në fushën kulturore mes popujve të dy vendeve, bazuar në respektin dhe besimin e ndërsjellë, bien dakord si më poshtë:

**Neni 1**

Qëllimi kësaj marrëveshjeje është krijimi i Qendrës Kulturore të Kinës në Tiranë, (referuar më poshtë si "Qendra").

**Neni 2**

Qendra është një institucion kulturor jofitimprurës i themeluar nga pala kineze që do të veprojë në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi.

**Neni 3**

Qëllimi i Qendrës është zhvillimi i marrëdhënieve miqësore, thellimi i mirëkuptimit, rritja e bashkëpunimit në fushën e kulturës dhe promovimi i ndërveprimit kulturor dhe artistik ndërmjet Republikës Popullore të Kinës dhe Republikës së Shqipërisë.

**Neni 4**

Funksionet e Qendrës janë:

1. Organizimi i veprimtarive kulturore në përputhje me qëllimin e saj;
2. Promovimi i gjuhës, kulturës dhe artit kinez përmes zhvillimit të aktivitete të ndryshme edukative;
3. Ngritja e bibliotekave, sallave të leximit dhe sallave të shfaqjeve filmike në ambientet e Qendrës me qëllim prezantimin e Republikës Popullore të Kinës dhe të kulturës kineze te publiku shqiptar;
4. Organizimi i aktiviteteve të tjera me natyrë kulturore, që janë në përputhje me qëllimin dhe me

parimet e kësaj Marrëveshjeje.

### **Neni 5**

Në organizimin e aktiviteteve të përmendura në Nenin 4 të kësaj Marrëveshjeje, Qendra mund të bashkëpunojë me institucionet e administratës publike, qendrore dhe vendore, institucionet kulturore dhe artistike dhe me qytetarët e Republikës së Shqipërisë.

Qendra ka të drejtën e hartimit dhe nënshkrimit të dokumenteve ligjore të nevojshme për funksionimin e saj në Shqipëri.

Qendra mund të hapë llogari (të) bankare në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi.

### **Neni 6**

Për mbulimin e shpenzimeve të saj Qendra ka të drejtë të vendosë tarifa të përshtatshme për artikujt jofitimprurës për aktivitete të tilla si:

1. Shfaqje, eksposita dhe aktivitete të tjera kulturore kineze;
2. Aktivitete edukuese që kanë të bëjnë me gjuhën dhe kulturën kineze;
3. Katalogje, postera, broshura dhe artikuj të tjerë që kanë lidhje të drejtpërdrejtë me aktivitetet e organizuara nga Qendra;
4. Shtëpitë e çajit dhe të kafesë që tregojnë mënyrën e jetesës tradicionale të Republikës Popullore të Kinës.

### **Neni 7**

Ministria e Kulturës e Shqipërisë do të ndihmojë, kur është e përshtatshme, për themelimin e Qendrës, sipas legjislacionit shqiptar. Çdo kosto që rezulton nga kjo ndihmë, do të mbulohet nga Ministria e Kulturës dhe Turizmit të Kinës.

### **Neni 8**

Pala kineze, në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi për ndërtimet, është përgjegjëse për projektimin, ndërtimin, rinvimin dhe dekorimin e ndërtesave të Qendrës pas marrjes së lejeve përkatëse. Kontraktuesi (t) i ndërtimit do të përcaktohet nga Pala kineze.

### **Neni 9**

Qendra, në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi, do të përashtohet nga taksat e importit/detyrimet doganore për artikujt e mëposhtëm, me kusht që ato të mos përdoren për shitje apo përfitime të tjera në Shqipëri si:

1. Mobiljet, objektet dhe pajisjet e zyrës që nevojiten për punët e përditshme administrative nga Qendra (pa përfshirë mjetet motorike);
2. Materiale të tjera që përfshijnë albume me foto, postera, libra, disqe, regjistrime, mjete edukuese dhe forma të ndryshme të produkteve audio-vizuale të nevojshme për organizimin e aktiviteteve nga Qendra;
3. Filmat që do të shfaqen në ambientet e Qendrës.

#### **Neni 10**

Për të ardhurat që do të paguhen nga Qendra për personelin e saj do të vendosen në përputhje me *Marrëveshjen midis Qeverisë së Republikës Popullore të Kinës dhe Qeverisë së Republikës së Shqipërisë për Shmangien e Taksave të Dyfishta dhe Parandalimin e Evazionit Fiskal, lidhur me Taksimin mbi të Ardhurat dhe Kapitalin*, nënshkruar në Pekin më 13 shtator 2004.

#### **Neni 11**

Personeli i ngarkuar nga Pala kineze për Qendrën, do të përbëhet nga shtetas që janë mbajtës të pasaportave të shërbimit të Republikës Popullore të Kinës. Personeli tjetër i Qendrës mund të jenë persona me shtetësi Kineze, Shqiptare ose i ndonjë vendi të tretë.

Në çdo rast Pala kineze do të informojë Palën shqiptare për emërimin dhe largimin e personelit të Qendrës duke përmbrushur në kohë procedurat përkatëse në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi.

Pala shqiptare do të sigurojë ndihmën e nevojshme dhe lehtësira të tjera në trajtimin e formalitetave të hyrjes dhe qëndrimit për personelin e Qendrës, bashkëshortët e tyre dhe fëmijët nën moshën 18 vjeç, në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi.

### **Neni 12**

Personeli me shtetësi kineze i Qendrës i caktuar nga Pala kineze do t'i nënshtronhet ligjeve dhe rregulloreve të punës dhe sigurimeve shoqërore të Kinës. Personeli tjetër i rekrutuar nga Qendra i nënshtronhet ligjeve dhe rregulloreve të punës dhe sigurimeve shoqërore Shqiptare.

### **Neni 13**

Çdo amendim i Marrëveshjes do të bëhet me miratimin e ndërsjellë të Palëve pas konsultimeve paraprake dhe do të hyjë në fuqi në përputhje me kërkesat e renditura në Paragrafin 1 të Nenit 15 të kësaj Marrëveshjeje.

### **Neni 14**

Çdo mosmarrëvëshje që lidhet me zbatimin e kësaj Marrëveshjeje do të zgjidhet përmes konsultimeve miqësore ndërmjet Palëve.

### **Neni 15**

Marrëveshja do të hyjë në fuqi në datën e marrjes së njoftimit të fundit me shkrim me anë të të cilit Palët informojnë njëra-tjetrën, nëpërmjet kanaleve diplomatike, se i kanë përbushur procedurat e tyre ligjore kombëtare për hyrjen në fuqi të saj.

Kjo Marrëveshje është e vlefshme për një periudhë pesë (5) vjeçare dhe vijon automatikisht për periudha të tjera pesëvjeçare, me përjashtim të rastit kur njëra Palë njofton Palën tjetër në formë të shkruar, gjashtë (6) muaj përpara mbarimit të periudhës së caktuar, për qëllimin e ndërprerjes së kësaj Marrëveshjeje.

Hartuar në dy (2) kopje në secilën gjuhë në..... më..... në gjuhën kineze, shqiptare dhe angleze. Të gjitha tekstet janë njëlloj autentike. Në rast keqkuptimi në interpretim, do të merret parasysh teksti në gjuhën angleze.

**PËR QEVERİNË E  
REPUBLIKËS POPULLORE**

**PËR KËSHILLIN E MINISTRAVE  
TË REPUBLIKËS**

NR.PROT. 3088/1  
DATË 5. 3. 2018

MINISTRISË PËR EVROPËN DHE PUNËT E  
JASHTME  
MINISTRISË SË FINANCAVE DHE EKONOMISË  
MINISTRISË SË KULTURËS  
MINISTRISË SË ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË  
MINISTRISË SË SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES  
SOCIALE

**Sekretari i Përgjithshëm**

Engjell AGACI



The image shows a handwritten signature of "Engjell AGACI" in black ink, positioned to the left of a circular official stamp. The stamp is also in black ink and contains the text "MINISTRISË SË FINANCAVE DHE EKONOMISË" around the top edge, and "Sekretari i Përgjithshëm" in the center. Below the stamp, there is some smaller, illegible text.